



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

## Study program

## Administrata publike krahasimtare e Bashkimit Evropian (2012/2013)

Fakulteti	Shkencat Shoqërore Bashkëkohore
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	60
Titulli	Magjistër i administratës publike / Drejtimi: AP krahasimtare BE-së
Numri në arkiv i akreditimit [60]	15-1190/6
Data akreditimit	18.10.2012

## Përshkrimi i programit

Përmes programit *administrata publike krahasimtare e BE-së* në UEJL, studentët do të përfitojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për kontribut konstruktiv në shoqëri përmes karrierës së tyre si menaxherë të ardhshëm, këshilltarë, analistë politik; në organizata qeveritare dhe jofitimprurëse.

## Karriera

Programi njëvjeçar *administrata publike krahasimtare e BE-së* është projektuar për të përgatitur studentët në fusha të tilla si, menaxhment, konsalting, analizat e politikave, e drejta. Ky program u mundëson aftësi dhe shkathtësi që të jenë në gjendje të punësohen në nivele të larta në sektorin publik dhe atë joqeveritar.

## Rezultatet e të mësuarit

### Njohuritë dhe të kuptuarit

- Ka njohuri të përparuara për teorinë në administratën publike, hulumtimin dhe praktikën.
- Ka njohuri dhe kuptim për administrimin publik krahasimtar për vendet e perëndimit.
- Ka njohuri të thella për organizimin dhe funksionimin e administrimit publik në vendet anëtare të UE.

### Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Vlerëson dhe jep mendim kritik në procedurën administrative.
- Planifikon dhe vepron efektivisht në administrimin dhe organizimin e shërbimeve publike.
- Tregon aftësi për vlerësim në fushën e administrimit publik krahasimtar, duke i pasur parasysh aspektet relevante, shkencore, sociale, etike, si dhe demonstroi vetëdije për etikën e aspekteve të punës.
- Njeh ndërlidhjen në mes proceseve administrative dhe veprimtarisë analitike për nevojat e krijimit të politikave.

## Aftësitë për të vlerësuar

- Vlerëson dhe gjykon për praktikën e ndryshme në organizatat qeveritare.
- Gjykon për problemet që ekzistojnë në administratën shtetërore, siç janë korrupsioni, nepotizmi dhe ndikimet politike.
- Mund të shfrytëzojë argumente të arsyeshme për vlerësimin e fakteve bazuar në studimet krahasimtare në politikën publike dhe menaxhimin publik.
- Mund të zhvillojë mendim kritik për aspekt krahasimtar të administrimit publik dhe i vlerëson përparësitë dhe mangësitë e sistemeve administrative në mënyrë të veçantë.

## Aftësitë e komunikimit

- Merr pjesë në debate publike dhe media, duke shfrytëzuar fjalor të nivelit profesional.
- Shkruan, propozon dhe udhëheq projekte hulumtuese në lëmin e administrimit publik.
- I shfrytëzon mjetet moderne për komunikim dhe teknologjitë e reja kur bëhet fjalë për institucione të ndryshme.

## Aftësitë e të mësuarit

- Është i aftë që t'i identifikojë nevojat individuale për studim autonom dhe ta realizojë këtë në një formë shumë autonome në lëmin e administrimit publik krahasimtar.
- Të ndihmojë në trajnimin dhe zhvillimin e njësiteve për pozicione të politikave dhe administrimit në sektorin publik.
- Tregon aftësi që të rishikojë modelet e klasifikimit të informatave, koncepteve dhe teorive të politikës publike dhe administrimit.
- Mund të dizajnojë një mënyrë tjetër të re për punë në administrimin publik në Maqedoni duke i shfrytëzuar edhe përparësitë e studimeve krahasimtare.
- Ka aftësi për planifikimin, organizimin dhe funksionimin e administrimit publik dhe institucionet në përputhje me sistemet bashkëkohore demokratike.

## Lista e lëndëve

### Semestri 1

- [6.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [6.0 SETK] **Aspekte krahasimtare të administratës publike në vendet e UE**
- [6.0 SETK] **Ekonomia aplikative në sektorin publik**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 1**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 2**

### Semestri 2

- [24.0 SETK] **Punimi i magjistraturës**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë 1**

## Description of courses

### Lëndë obligative

- **Metodologjia e hulumtimit**

Kjo lëndë është e dizajnuar për studentët të cilët përgatiten për punimin e tezës së magjistraturës. Qëllimet kryesore janë që studentëve t'u ofrohen mjete për konceptualizimin e tezës së tyre me qëllim të gjetjes së çështjes së hulumtimit si dhe njohjen e metodave për mbledhjen e të dhënave përmes analizës cilësore dhe sasiore. Lënda është e fokusuar tek problemet e metodave dhe teknikave cilësore, siç është analiza statistikore, tekste që janë të lidhura me teorinë dhe testimin e hipotezave. Më pastaj të rëndësishme janë, po ashtu, edhe temat për interferencë deskriptive dhe kauzale, longitudinale, studime krahasimtare dhe studime të rasteve. Qëllimi është analiza e të dhënave cilësore, vënia finale e të gjitha praktikave teorike dhe veprave në funksion të dizajnit të shkrimit të temës.

- **Aspekte krahasimtare të administratës publike në vendet e UE**

Përmes kësaj lënde, studentët do të pajisen me njohuri për karakteristikat themelore të administratës publike në vendet e BE-së. Qëllimi kryesor është të hulumtohen llojet, si forma të veprimit në institucionet e administratës publike në shoqëri të ndryshme, me qëllim që studentët të fitojnë njohuri dhe koncepte të reja për administratën publike. Përmes kësaj lënde, studentët do të njihen me rëndësinë e administratës publike në shtete të ndryshme, do të njihen edhe me sisteme të ndryshme organizative dhe administrative të shteteve. Gjithashtu, studentëve do t'u mundësohet ta kuptojnë strukturën organizative dhe funksionimin e institucioneve ekzekutive-administrative, por edhe format tjera si dhe institucionet e administratës publike. Këto njohuri për studentët janë të rëndësishme posaçërisht lidhur me globalizimin dhe rëndësinë e integritimit. Objekti i studimit përbëhet nga: nocionet dhe njohuritë themelore për parimet dhe institucionet e administratës publike, strukturat dhe funksionimi i administratës publike në shtete të ndryshme, menaxhimi i ri publik, globalizimi si dhe hapat që Republika e Maqedonisë i ndërmerr për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

- **Ekonomia aplikative në sektorin publik**

Ekonomia në përgjithësi ndikon në atë se sa ne në mënyrë efikase kujdesemi për planetin tonë për të ardhmen e së cilës dëshirojmë të jemi pjesë ne, rreth burimeve të cilat i disponojmë, rreth asaj se deri në cilin nivel ne kujdesemi për të varfrit dhe të pasurit. Por duhet, në mënyrë të veçantë të potencohet se parimet ekonomike dhe konceptet pa dallim të nivelit të zhvillimit ekonomik nuk ndryshojnë. Kjo lëndë në sektorin publik ka për qëllim ta përkufizojë ekonominë dhe rolin e shtetit në ekonomi, rolin e institucioneve publike në ekonomi. Po ashtu ka për qëllim të përkufizojë ofertën dhe kërkesën agregate, ndikimin e politikës fiskale dhe monetare ndaj tregjeve.

- **Punimi i magjistraturës**

Ky modul u mundëson studentëve që të transferojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre për kërkime dhe për të bërë detyra më të ndërlikuara - punimin e magjistraturës. Moduli synon të jetë plotësisht praktik dhe studentët të fitojnë njohuritë e nevojshme, por edhe aftësitë dhe shkathhtësitë që t'i qasen shkrimit të punimit. Moduli ka një rezultat kthyes - t'u mundësojë studentëve ta shkruajnë punimin e magjistraturës me vështirësi minimale dhe me një efikasitet maksimal. Lënda ka për qëllim përmirësimin e teknikave të hulumtimit dhe stilin e shkrimit të punimit, duke mbajtur llogari për ndalesën e shërbimit me mjete të palejuara, siç janë: plagjiatura dhe cenimi i të drejtave të autorit, që janë të ndaluara me Statutin e UEJL-së.

## Lëndë zgjedhore

- **E drejta administrative**

Kjo lëndë mundëson njohuri dhe arritje në të drejtën administrative në tre komponentë: \* e para, e drejta administrative si degë e shkencës juridike dhe marrëdhëniet e saj me degët tjera; \* e dyta, e drejta administrative si degë e sistemit juridik (e drejta pozitive) të Republikës së Maqedonisë – posaçërisht e drejta pozitive; \* e treta, e drejta administrative, nacionale dhe pozitive, në pajtueshmëri me aspektet ndërkombëtare, duke i përfshirë edhe rastet e të drejtës administrative. Vëmendje e posaçme do t'i kushtohet legjislaturës pozitive në fushën e të drejtës administrative si dhe punës së studentëve në: \* organizimin e administratës shtetërore dhe publike; \* qeveri dhe shërbimet publike; \* aktet administrative në administratë; \* kontrollin e organeve administrative nga ana e Parlamentit, prokurori publik, organizatat joqeveritare e kështu me radhë.

- **Analiza e politikave publike**

Lënda ka për qëllim që t'u mundësojë studentëve që ta përkufizojnë dhe ta ilustrojnë analizën e politikave dhe rolin e tyre në krijimin dhe transformimin e informatave relevante për politikën. Nuk ka pajtueshmëri me faktin se si konkretisht dhe në mënyrë shumë precize të përkufizohet politika publike. Studentët do të kenë mundësi që të njihen me këtë fushë dhe në mënyrë kritike, ta analizojnë zhvillimin dhe shfaqjet në lëmin e politikave publike. Analiza e politikave publike është disiplinë për zgjidhjen e problemeve të cilat kërkojnë njohuri nga metodologjia dhe teorinë

bazike të shkencave shoqërore, të profesioneve shoqërore dhe të filozofisë së politikave.

- **Menaxhmenti strategjik**

Ky modul është i dizajnuar që të aftësojë studentët të përdorin mjete brenda kornizave të krahasimit të strategjive efektive. Temat e ndryshme përfshijnë korniza konceptuale për kuptimin e rolit të lidershit strategjik, aftësi analitike dhe zhvillimore dhe vlerësimin e strategjive dhe të qasjes ndaj punës me grupe të ndryshme të interesit, me qëllim të mobilizimit të përkushtimit, si dhe metoda të udhëheqjes kah arritja e ndryshimeve. Gjithashtu, ky është një modul multidisiplinar i cili hulumton rrethanat historike, politike, të së drejtës, rrethanat etike dhe sociale në të cilat funksionojnë bordi dhe menaxherët ekzekutiv si dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e organizatës.

- **Sistemet politike krahasimtare**

Lënda sistemet politike krahasimtare, ka për qëllim të furnizimit të studentëve me njohuri rreth politikave më të zhvilluara në periudhën e sotme, nënkuptohet duke mos i lënë mënjanë edhe vendet të cilat e rrethojnë RM-në si dhe sistemet politike të vendeve më pak të zhvilluara në të gjithë botën. Kjo lëndë është pjesë e studimeve deridiplomike dhe studimeve pasdiplomike në të shumtën e rasteve në fakultetet e administrimit publik, në fakultetin juridik si dhe në fakultetin e shkencave politike. Në përmbajtjen e të gjithë lëndës bëhen paralele dhe analiza krahasimtare në mes të funksionimit të institucioneve të sistemeve politike në vendet të cilat mësohet, si në mes vetes ashtu edhe në rastin e sistemit politik në republikën e Maqedonisë, në drejtim të gjetjes së praktikave të mira me të cilat do të avancohej ky sistem në Republikën e Maqedonisë.

- **Menaxhimi i sistemeve informative**

Përmes lëndës menaxhimi i sistemeve informative jepet një hyrje e përgjithshme e sistemeve të informimit, në prizmin organizativ dhe shoqëror. Qëllimi është që studentët të aftësohen me një teknikë balanci në mes teknikave organizative me perspektivë, të cilat do t'u shërbejnë si bazë për studimet e mëtejme në këtë lëmi.

- **Lidershipi dhe zhvillimi organizativ**

Në lëndën lidershipi publik dhe zhvillimi organizativ, mësimi zbatohet si pjesë e programit studimor në administrimin publik. Lënda ka për qëllim që t'u mundësojë studentëve mënyrën si e zhvillojnë dhe si zbatojnë liderët dhe udhëheqësit arritjen e misioneve dhe vizioneve të organizatave të caktuara në sektorin publik, zhvillimin e vlerave të cilat janë të domosdoshme për suksesin e mëtejme dhe zbatimin e tyre përmes aktiviteteve të ndryshme dhe shprehive, si do t'i zbatojnë dhe do të zhvillohen liderët dhe organizata. Gjithashtu, do të flitet për mënyrën se si organizata e zbaton misionin e saj dhe vizionin përmes një strategjie të qartë të bazuar në mendimet të gjitha palëve të interesuara, dhe e përkrahur nga të gjitha politikatat relevante, planet, proceset dhe qëllimet.

- **Kapituj të zgjedhur nga aplikacionet e TI për përpilimin e një punimi shkencor**

Ky modul u mundëson studentëve që të transferojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre për kërkime dhe për të bërë detyra më të ndërlikuara - punimin e magjistraturës. Moduli synon të jetë plotësisht praktik dhe studentët të fitojnë njohuritë e nevojshme, por edhe aftësi dhe shkathtësi që t'i qasen shkrimit të punimit. Moduli ka një rezultat kthyes - t'u mundësojë studentëve ta shkruajnë punimin e magjistraturës me vështirësi minimale dhe me një efikasitet maksimal. Lënda ka për qëllim përmirësimin e teknikave të hulumtimit, si dhe stilin e shkrimit të punimit, duke mbajtur llogari për ndalesën e shërbimit me mjete të palejuara, si: plagjiatura dhe cenimi i të drejtave të autorit, që janë të ndaluara me Statutin e UEJL-së.

- **Aplikacione statistikore për përpunimin e të dhënave.**

Ky modul u mundëson studentëve që të transferojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre për kërkime dhe për të bërë detyra më të ndërlikuara - punimin e magjistraturës. Moduli synon të jetë plotësisht praktik dhe studentët të fitojnë njohuritë e nevojshme, por edhe aftësi dhe shkathtësi që t'i qasen shkrimit të punimit. Moduli ka një rezultat kthyes - t'u mundësojë studentëve ta shkruajnë punimin e magjistraturës me vështirësi minimale dhe me një efikasitet maksimal. Lënda ka për qëllim përmirësimin e teknikave të hulumtimit, si dhe stilin e shkrimit të punimit, duke mbajtur llogari për ndalesën e shërbimit me mjete të palejuara, si: plagjiatura dhe cenimi i të drejtave të autorit, që janë të ndaluara me Statutin e UEJL-së.